



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

VENDIM

NR. 161/3 DATË 3.9.2019

“Mbi korigjimin e gabimeve materiale në vendimin nr.161, datë 18.06.2019”

Sot në datë 03.09.2019, trupi gjykues, i përbërë nga:

Olsi Komici	Kryesues
Lulzim Hamitaj	Anëtar
Brunilda Bekteshi	Relatore

Bazuar në nenin 112 të Kodit të Procedurave Administrative: “Korigjimi i gabimeve materiale në aktin administrativ” sipas të cilit përcaktohet se:

- “1. Organi publik, në çdo kohë, kryesisht apo me kërkesë, mund të korigjojë gabimet e shkrimit, gabimet në përlogaritje dhe pasaktësi të tjera të dukshme, në një akt administrativ.*
- 2. Organi publik ka të drejtë të kërkojë kthimin e aktit administrativ të shkruar që korigjohet, si dhe të çdo kopje të njësuar të tij.”,*

u mbledh për t’u njohur me kërkesën e relatorit të çështjes znj. Brunilda Bekteshi, për korigjimin e gabimeve materiale në vendimin e subjektit të rivlerësimit Kastriot Selita, për të cilin mbajti procesverbalin përkatës. Në procesverbal raportohet mbi arsyet e pranimit të korigjimit të vendimit, pas të cilit arrihet në konkluzion se, në vendimin nr.161 datë 18.06.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në pjesën arsyetuese të vendimit të titulluar “Denoncimet e paraqitura në Komision”, numri “17” duhet të zëvendësohet me numrin “18”; fjalët “*ndërsa tre*” duhet të zëvendësohen me fjalët “*ndërsa katër*”, si dhe fjalët e sakta “*ndërsa katër*” duhet të shoqërohet me *footnotin e denoncimit përkatës*.

Trupa gjykuese pasi konstatoi se kërkesa e relatores qëndron dhe pasaktësitë janë vendosur dukshëm si pasojë e gabimeve materiale, në faqen nr. 55 të vendimit përfundimtar të subjektit të rivlerësimit z.Kastriot Selita;

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr.161, datë 18.06.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit:

a. Në pjesën arsyetuese të vendimit të titulluar “Denoncimet e paraqitura në Komision”:

- 1) numri “17” në togfjalëshin “Në Komision janë depozituar 17 denoncime nga publiku për subjektin e rivlerësimit” zëvendësohet me numrin “18”.
- 2) fjalët “*ndërsa tre*” në togfjalëshin “...ndërsa tre denoncime nuk përmbushnin kërkesat e nenit 53, të ligjit nr. 84/2016”, zëvendësohet me fjalët “*ndërsa katër*”.
- 3) Fjala e saktë “*ndërsa katër*” shoqërohet me “*footnote*” me përmbajtje “*Denoncimi nr. *** prot. datë 13.05.2019 i shtetasit E. J.*”.

2. Të njoftojë subjektin e rivlerësimit, Komisionerin Publik dhe Vëzhguesin Ndërkombëtar për këtë korrigjim.

3. Vendimi i korrigjuar të publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Trupi Gjyqesore

Olsi Komici	Kryesues
Lulzim Hamitaj	Anëtar
Brunilda Bekteshi	Relatore

Sekretare gjyqesore
Denisa Kosta